



THIRRJE PËR REKRUTIM EKSPERTËSH TË JASHTËM

Këshilli i Ankesave, referuar nenit 20, pika 6 të Ligjit 97/ 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili parashikon se: *“Këshilli i Ankesave, me ekspertizë të pavarur, mund të organizojë anketime të publikut për problemet etike të programeve, përfundimet e të cilave ia raporton AMA-s, duke sugjeruar masat për përmirësim..”* kërkon të organizojë me ekspertizë të pavarur një konferencë shkencore me titullin **“Fake News dhe sfida për të vërtetën në media” në datë 02.10.2017**. Autoriteti Kontraktues (AMA), kërkon të rekrutojë 5 (pesë) ekspert të jashtëm, Analistë/Gazetar të kualifikuar të fushës së medias, të cilët do të referojnë me qëllim hapjen e një debati të gjerë mes profesionistëve të fushës së medias dhe në publikun e gjerë në mënyrë që të mundësohet identifikimi dhe minimizimi i përhapjes së lajmeve të rreme si dhe rritja e shkallës së njohjes dhe informimit të aktorëve mediatikë dhe audiencës.

TERMAT E REFERENCES

Objektivi

Disa nga objektivat kryesore të kësaj konference janë përmirësimi i standarteve profesionale në mediat audio-vizive dhe në mediat e tjera, marrja e vendimeve të informuara në përzgjedhjen dhe verifikimin e informacionit që do të publikohet apo transmetohet dhe shmangia e depërtimit të lajmeve të rreme dhe të përmbajtjeve që çënojnë standartet dhe besueshmërinë e medias.

Detyrat

Analistë/Gazetar, ekspertë të fushës së medias, do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Ankesave, për realizimin e temave të referateve të cilët do t’u përmbahen këtyre akteve:

1. Facebook apo Fakebook: Sa i ekspozuar është televizioni ndaj lajmeve të rreme që vijnë nga mediat sociale dhe nga mjedisi online.
2. “Post fact era” do të thotë “Opinion era”? – Mbi “të vërtetën” që përcillet përmes opinioneve në programet e formatit “Talk Show”.
3. Të shohësh do të thotë të besosh – Mbi problematikat që lidhen me manipulimin e imazhit televiziv.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

4. Kasetat e gatshme dhe “e vërteta” që vjen nga zyrat e marrëdhënieve publike.
5. “Media Literacy” si alternativë ndaj “Fake news”.
6. Fake News: Koha për t’u kthyer në themelet e gazetarisë.
7. Fake News, nën optikën ligjore dhe atë të vetërregullimit.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm të fushës së medias:

- CV e nënshkruar, e shoqëruar me fotokopje të kartës së ID;
- Paraqitja në gjuhën shqipe të Abstraktit mbi studimin në lidhje me referimin që do të mbahet në konferencë.
- Eksperienca të mëparshme në formulim të detyrave të ngjashme

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë

APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 27 SHTATOR, 2017

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

ALBA QIRJAZI